



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 181/2 prot

Datë 31.01.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË TJERË

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “ELAL COM” SHPK dhe “MELA” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*” me Nr. REF-49455-11-10-2022, me objekt “Investime ne kuader te projektit ” Bashki me shfrytezim inteligjen energjie “ (Bashki te zgjuara energjie)”, me fond limit 65,687,642.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.12.2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër.
- Ankimues:** BOE “PREKA” SHPK “NDËRTUESI 2014” SHPK
Adresa: Rr. “Marin Bicikemi”, Lagja 3 heronjt (Preka) dhe Rr. “Daut Borici” (Ndërtuesi 14), Shkodër
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Shkodër
Adresa: Rruga “13 Dhjetori”, Tiranë.
- Subjekte të interesuar:** BOE “ELAL COM” SHPK dhe “MELA” SHPK
Adresa: Vaqarr, Tiranë

Në datën 30.01.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me numër 181 prot., e bashkimit të operatorëve ekonomik “PREKA” SHPK “NDËRTUESI 2014” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*” me Nr. REF-49455-11-10-2022, me objekt “Investime ne kuader te projektit ” Bashki me shfrytezim inteligjen energjie “ (Bashki te zgjuara energjie)”, me fond limit 65,687,642.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.12.2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kundërshtimin e kualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomik “ELAL COM” SHPK dhe “MELA” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërmat “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin*

e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë kriteret e kualifikimit për të cilat operatori ekonomik ankimes BOE “PREKA” SHPK “NDËRTUESI 2014” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga bashkimi i operatorëve ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit “ELAL COM” SHPK dhe “MELA” SHPK.

Konkretisht:

Kapacitetin teknik pikën 2.3.10:

2.3.10 Ofertuesi pjesëmarrës në tender duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për materialet e mëposhtme në mënyrë që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të percaktuara në specifikimet teknike.

1. Autorizim të prodhuesit/Distributorit të autorizuar për mallrat e kërkuara. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim distributori operatori ekonomik ta vertetojë këtë duke paraqitur kontratë premtimi, letër angazhimi / akt-marreveshje lidhur me Kompanisë prodhuese dhe Distributorit të autorizuar.

2. Katalogun/et ose skedat teknike për të gjitha mallrat e kërkuara, të cilat duhet të përputhen me përshkrimin e bërë në specifikimet teknike dhe çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE.

Në rast se dokumentet e mesipërme janë në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Nr	Pershkrimi	Njesia	Sasia
1	Ndriçues dekorativ led/ > 10.000 lumen/ 4000k+ krahun	cope	1
2	Ndriçues dekorativ led/ >10.000 lumen/ 3000k (I varur)	cope	1
7	Kuader komandimi	cope	1
8	Kabell 3x1.5 mm ²	ml	1
9	Kabell 4x6 mm ²	ml	1
10	Kabell 4x10 mm ²	ml	1
11	Percjelles tokezimi bakri S=16mm ²	ml	1
12	Krah nje degesh per shtylle metalike	cope	1

Kriteri: 2.3.11 Operatori ekonomik i shpallur fitues brenda **(7) shtate diteve** nga marrja e njoftimit të klasifikimit duhet të paraqesë mostrat për artikujt si më poshtë. Mos paraqitja e mostrave pranë Bashkisë Shkoder, Drejtoria e Sherbimeve Publike ose mos përputhja e tyre me specifikimet teknike të publikuara përben kusht për skualifikim dhe AK do të vazhdojë me shpalljen fitues të ofertuesit të radhës në renditje.

Nr	Pershkrimi	Njesia	Sasia
1	Ndriçues dekorativ led/ > 10.000 lumen/ 4000k+ krahun	cope	1
2	Ndriçues dekorativ led/ >10.000 lumen/ 3000k (I varur)	cope	1
7	Kuader komandimi	cope	1

8	Kabell 3x1.5 mm ²	ml	1
9	Kabell 4x6 mm ²	ml	1
10	Kabell 4x10 mm ²	ml	1
11	Percjelles tokezimi bakri S=16mm ²	ml	1
12	Krah nje degesh per shtylle metalike	cope	1

Kapacitetin teknik pikën 2.2.3:

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2022 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2022.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Kapacitetin teknik pikën 2.3.6:

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve të siguruar për muajin e fundit duhet të jetë 32 (Tridhjetë e dy).

Lidhur me këte pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i përcaktuar numri i punonjësve të siguruar për periudhën e mësipërme, shoqëruar me listepagesat perkatese E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shëndetsore.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Kapacitetin teknik pikën 2.3.8:

2.3.8 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :

Nr	Mjetet	Sasia
1	Mjet transporti veteshkarkues mbi 7 ton (kapac.mbjates)	2 copë
2	Mjet transporti me ngarkese mbi 1.5 tone	1 copë
3	Autovinc me kosh	2 copë
4	Matrapik	1 copë
5	Betoniere 1-2 m ³	1 copë
6	Grejder	1 cope
7	Rrul	1 cope
8	Autobitumatrice	1 cope
9	Asfaltoshtruese	1 cope

10	Trapano elektrike	1 cope
11	Aparate Luxmeter per fluksin e ndricimit	1 cope

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike Operatori duhet te paraqese:

- i. Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).
- ii. Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore te blerjes.
- iii. Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.
- iv. Per mjetet e marra me qera qe shenohen ne rregjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Kurse per mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Periudha e garancise per defektet eshte 2 vjet pas marrjes ne dorezim te objektit (hartimit te procesverbalit te marrjes ne dorezim dhe certifikates)

Kapacitetin teknik pikën 2.3.7:

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjes të pasqyruar në listëpagesa për të paktën muajin e fundit, te paisur me kontrate pune (te vlefshme), ose te kontraktuar posacerisht per te realizuar kete kontrate apo ne rastin kur makinerite jane me qera per manovratorët, me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të leshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë, ku nga këta të jenë të paktën:

Murator	10 (dhjete) punonjës
Elektracist	8(tete) punonjes
Teknik ndertimi	1 (nje) punonjes
Manovrator	2 (dy) punonjes
Puntor asfalti	4 (kater) punonjes

Manovratorët duhet të jenë punonjës te specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda(Eskavatorist) dhe (Automakinist) dhe për këtë duhet të paraqesin deshmi nga Drejtoria e Sherbimit te Transportit Rrugor ndersa per teknikun e ndertimit duhet te paraqitet diploma e shkolles/deshmi nga organe/institute te akredituar.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

-Referuar faktit që ofera është paraqitur si bashkim operatorësh ekonomik, në bazë të të dhënave që kemi marrë rezulton se ndarja e punimeve nuk është bërë në përputhje me kapacitetet teknike që disponon secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomik.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 31.01.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri